



UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000
Prizren, Republika e Kosovës
www.uni-prizren.com

RREGULLORE PËR BOTIME NGA UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN

Prizren, 2022



Bazuar në nenin 4 të Ligjit për veprimitari botuese dhe librin, nr.02/L-51, nenin 25 të Ligjit për Arsimin e Lartë nr.04/L-037 dhe në nenin 231, 232, 233, 234 të Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, Senati i Universitetit, më datë: 23.11.2022, miraton:

RREGULLOREN PËR BOTIME NGA UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

- 1.1. Me këtë Rregullore përcaktohet themelimi i këshillit botues dhe veprimtarisë së shtëpisë botuese në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren.
- 1.2. Kjo Rregullore definon dhe përcakton kushtet dhe procedurat e botimit, e ribotimit dhe e përkthimit të teksteve bazike, të teksteve të tjera, të praktikumeve, të përbaledhjeve, të detyrave dhe të publikimeve të tjera të veçanta (monografi dhe periodikë) të karakterit profesional, shkencor, letrar, artistik dhe informativ (në tekstin e mëtejmë: publikimet).
- 1.3. Botues i këtyre publikimeve është Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” (më tej: Universiteti).

Neni 2

- 2.1. Publikimet botohen në bazë të Planit botues.
- 2.2. Planin botues e miraton Këshilli Botues i Universitetit (në tekstin e mëtejmë: Këshilli Botues) për çdo vit akademik, sipas propozimeve të njësive akademike dhe të njësive organizative.
- 2.3. Plani botues propozohet nga njësiti akademike në nëntor, ndërsa vlen për vitin vijues kalendarik.

Neni 3

- 3.1. Në publikimet e teksteve bazike, të teksteve të tjera, të praktikumeve, të përbledhjeve të detyrave përfshihet materia e një lënde mësimore, përkatësisht e fushës së caktuar.
- 3.2. Publikimet duhet t'i përbajnjë arritjet profesionale, shkencore, letrare dhe artistike, në pajtim me kërkesat bashkëkohore metodologjike dhe pedagogjike.
- 3.3. Autorë të teksteve mund të janë mësimdhënësit në marrëdhënie të rregullt pune në Universitet. Në raste të veçanta, autorë/bashkautorë mund të janë edhe nga stafi i pensionuar i Universitetit.
- 3.4. Këshilli botues mund të lejojë edhe botimin e publikimeve të personaliteteve të shquara që nuk janë pjesë e stafit të Universitetit. Arsyetimi i autorit në fjalë duhet të jetë i mirë-argumentuar (pamundësia e tij financiare për të botuar dhe përsitimet që kanë indirekt studentët nga titulli i botuar).



Këshilli Botues i Universitetit

Neni 4

4.1. Këshilli Botues përbëhet nga 5 anëtarë me të drejtë vote:

- Prorektor/i/ja për kërkime shkencore
 - 4 (katër) ekspertë të fushave që studiohen në Universitet (Juridik, Ekonomik, Filologji, Shkenca të jetës dhe mjedisit, Mësimdhënie, Kompjuteristikë). Për shkencat që nuk janë përfshirë në Këshillin botues, Senati emëron redaktor profesional.¹
- 4.2. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.
- 4.3. Anëtarët e Këshillit Botues i propozon rektori, ndërsa i zgjedh Senati i Universitetit, sipas fushave përkatëse të studimit në Universiteti.
- 4.4. Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjat katër vjet.
- 4.5. Kryetari i Këshillit Botues zgjidhet nga anëtarët e tij.

Neni 5

- 5.1. Këshilli Botues, përveç të tjera, e shqyrton dhe e lejon botimin e publikimeve në bazë të pëlgimit me shkrim të këshillit të njësisë akademike, të së paku dy recensentëve të fushës përkatëse dhe të redaktorit.
- 5.2. Këshilli Botues vendos për zgjedhjen ideore të ballinës dhe për redakturën e tekstit.
- 5.3. Logoja e Universitetit vendoset vetëm në botimet që rrjedhin nga shtëpia botuese e Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren.

Neni 6

- 6.1. Anëtarët e zgjedhur të Këshillit Botues janë njëkohësish edhe redaktorë të publikimeve universitare nga fusha shkencore, profesionale e artistike, së cilës i përkasin.
- 6.2. Recensentët dhe redaktori mbajnë përgjegjësi për cilësinë e dorëshkrimeve, për nivelin profesional dhe shkencor të dorëshkrimeve.
- 6.3. Redaktori në bazë të vlerësimit pozitiv të recensentëve dhe të analizës së dorëshkrimit, i jep mendim me shkrim Këshillit Botues për lejimin e botimit të dorëshkrimit.
- 6.4. Punën e vet redaktuese për një dorëshkrim redaktori është i obliguar ta kryejë brenda afatit prej 30 ditësh që nga dita kur e merr dorëshkrimin e kompletuar.
- 6.5. Autori mban përgjegjësi për cilësinë dhe për originalitetin e punimit.

Neni 7

- 7.1. Këshilli Botues jep ide, mendime dhe pikëpamje për politikën dhe për avancimin e publikimeve universitare.
- 7.2. Këshilli Drejtues dhe Senati e mbështesin Këshillin Botues për realizimin e publikimeve universitare.
- 7.3. Këshilli Botues për punën e vet i përgjigjet Senatit.

¹ Koriguar me vendim të Senatit, nr. prot. 01-614, datë: 23.11.2022



Procedura e botimit të publikimeve

Neni 8

- 8.1. Lejen për botimin e publikimeve e jep Këshilli Botues i Universitetit.
- 8.2. Dorëshkrimet e publikimeve nga neni 1 i kësaj Rregulloreje i nënshtrohen recensimit, të cilin e bëjnë së paku tre anëtarë të fushës përkatëse.
- 8.3. Recensemtë i cakton këshilli i njësisë akademike.
- 8.4. Recensemtë kanë obligim që të shkruajnë recension pozitiv apo negativ. Raporti i tyre mund të jetë i përbashkët apo i ndarë.
- 8.5. Raporti i recensemtëve duhet të dorëzohet brenda afatit të precizuar në vendimin për emërimin e tyre.
- 8.6. Dorëshkrimi pranohet në procedurën e mëtejme për botim nëse i ka pozitive së paku dy recensionet.

Neni 9

- 9.1. Para pranimit të dorëshkrimit nga Këshilli botues, krahas deklaratës nën betim për autorësinë dhe origjinalitetin nga ana autorit/autorëve, punimi duhet t'i nënshtrohet kontrollit për plagjiaturë/vetë-plagjiaturë.
- 9.2. Raporti i kontrollit për plagjiaturë/vetë-plagjiaturë nuk duhet të kalojë vlerën 20% dhe si i tillë duhet t'i përcillet Këshillit botues.

Neni 10

- 10.1. Autori duhet ta dorëzojë dorëshkrimin dhe recensionet pozitive së paku prej dy recensemtëve. Dorëshkrimi duhet të jetë i shtypur në letër (me lidhje të butë) dhe në version elektronik original (Word, LaTeX etj.) dhe PDF (dhe i radhitur me kompjuter).
- 10.2. Dorëshkrimi i teksteve bazike, i teksteve të tjera, i praktikumeve dhe i përbledhjeve të detyrave duhet të jetë në pajtim me planin dhe programin e lëndës mësimore, përkatësisht të asaj fushe.
- 10.3. Dorëshkrimi duhet të jetë i lekturuar dhe i korrektuar.
- 10.4. Autori, bashkë me dorëshkrimin sipas pikës 3 të këtij nenit dhe me recensionet duhet ta dorëzojë edhe planin e programin mësimor të lëndës përkatëse, të asaj fushe, të vërtetuar nga njësia akademike.
- 10.5. Me rastin e aplikimit, autori/autorët nënshkruan/nënshkruajnë deklaratë për origjinalitetin e punimit dhe për përgjegjësitë e tjera.
- 10.6. Këshilli botues harton dhe aprovon formularë për procesin e aplikimit.

Neni 11

- 11.1. Në rast se redaktori i bën vërejtje autorit ose recensemtëve për dorëshkrimin, kurse ata nuk veprojnë sipas vërejtjeve e sugjerimeve në afatin e caktuar, konsiderohet se heqin dorë nga procedura e mëtejme.
- 11.2. Për rastet e mospjatimit eventual të autorit dhe të recensemtëve me vërejtjet e redaktorit, sipas paragrafit 1 të këtij nenit, vendos Këshilli Botues.

Neni 12

- 12.1. Përparësi botimi kanë: publikimet origjinale, sidomos për lëndët mësimore që nuk kanë tekstu bazë universitar dhe publikimet të cilat me plane dhe programe mësimore



janë literaturë e domosdoshme për studentë si dhe

- 11.1. Përkhimet e teksteve bazike me rëndësi të veçantë profesionale, shkencore, letrare dhe artistike.

Neni 13

- 13.1. Publikimet e Universitetit përmbajnë: emrin e Universitetit, emrin e njësisë akademike, emrin dhe mbiemrin e autorit/autorëve, titullin e tekstit, stemën e Universitetit, vandin dhe vitin e botimit.
- 13.2. Faqja e parë dhe e dytë janë të zbrazëta.
- 13.3. Faqja e tretë është e njëjtë sikurse ballina, por pa ngjyra.
- 13.4. Faqja e katërt: emrat e recensentëve, të kryetarit të Këshillit Botues, të redaktorit, të botuesit (Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren) dhe në fund numrin e vendimit me këtë përmrbajtje: Këshilli Botues i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren lejoi publikimin dhe përdorimin e këtij teksti me vendimin nr. _____ të datës _____._____.
- 13.5. Faqja e pestë: përmrbajtja.
- 13.6. Pas përmrbajtjes pason parathënia në faqen numër tek (në anën e djathtë), teksti i publikimit, kurse pas tekstit - literatura, indeksi i emrave, indeksi i nocioneve dhe në faqen e fundit - emri dhe mbiemri i autorit, titulli i publikimit, emri dhe mbiemri i lektorit, i korrektorit, i redaktorit artistik, i realizuesit kompjuterik dhe i autorit të ilustrimeve.
- 13.7. Falënderimi për sponsorët mund të jetë në faqen e parafundit.
- 13.8. Në faqet e tekstit figuron emri i autorit dhe titulli i publikimit.
- 13.9. Në publikim jepet edhe ky shënim: Të gjitha të drejtat e autorit mbrohen me ligj.
- 13.10. Formati i botimeve të Universitetit është B5 (17 x 24 cm). Radhitja duhet të bëhet sipas fontit Times New Roman, me madhësi të shkronjave 11, me rrallim rreshtash 1.0.
- 13.11. Botimet e veçanta mund të kenë zgjidhje teknike e artistike të veçantë.
- 13.12. Në faqen e fundit të publikimit botehet katalogimi (CIP) në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, kurse ISBN-ja edhe në kopertinën e prapme.

Financimi i botimit të publikimeve

Neni 14

- 14.1. Vlerësimi i shpenzimeve të botimit të shprehet në valutë (euro - €) dhe për bazë llogaritjeje merret faqja e tekstit të botuar.
- 14.2. Caktimi i pikëve bëhet si në vijim:
- 14.2.1. Për redaktor - 1 € për faqe.
- 14.2.2. Për recensem - 2 € për faqe (shuma pjesëtohet varësisht nga numri i recensentëve).
- 14.2.3. Për lekturë dhe korrekturë - 1 € për faqe.
- 14.2.4. Kostot e botimit të tekstit prej minimalisht 100 kopjeve i bartë Universiteti.
- 14.2.5. Kompensimi për të drejtat e autorit përkufizohet në bazë të marrëveshjes ndërmjet shtëpisë botuese dhe autorit/autorëve të tekstit, respektivisht 20 % nga shitja e secilës kopje të tekstit.
- 14.2.6. Kompensimi i autorit/autorëve bëhet çdo vit pas nxjerrjes së bilancit të shitjes.
- 14.3. Për përkthim të tekstit universitar honorari do të jetë 12 € për faqe.
- 14.4. Në rast të kërkesave për përkthim, autori/autorët paraprakisht duhet ta kontaktojnë



shtëpinë botuese dhe të informohen për kushtet e bartjes së të drejtës për përkthim, të cilat do të merren parasysh në vendimin e Këshillit Botues. Nëse Këshilli Botues merr vendim pozitiv, atëherë Universiteti (përmes Këshillit Botues) i drejtohet shtëpisë botuese apo autorëve me kërkesë zyrtare për të drejtën për përkthime. Vetëm pas marrjes së lejes, autori/autorët do të mund ta fillojnë përkthimin dhe pasi ta kenë finalizuar, ta bëjnë kërkesën e ardhshme në Këshillin Botues, duke ia bashkëngjitur edhe raportin e recensentëve dhe duke i përbushur kërkesat e tjera sikur në rastin e publikimeve të tjera.

- 14.5. Nëse shpenzimet e publikimit i ka mbuluar autori, 80% e mjeteve të realizuara nga shitja do të shkojnë tek autori, ndërsa 20% i takojnë Universitetit.
- 14.6. Nga çmimi kushtues i shitjes së publikimit i takon:
- 14.7. Prej momentit të themelimit të Librarisë Universitare (në kuadër të Bibliotekës Universitare), shitja e publikimeve do të bëhet në atë librari dhe në pikat tjera (librari) të shitjes dhe mjetet do të derdhen në llogarinë e Universitetit.
- 14.8. Mjetet nga shitja e publikimeve i kthehen Universitetit sipas dinamikës së shitjes së publikimit.
- 14.9. Në cilëndo mënyrë të financimit të publikimeve (me financim të Universitetit apo vetëfinancim), çmimi i shitjes dhe vendi i shitjes caktohet në mënyrë të njëjtë (dhe në bazë të kësaj rregulloreje), ndërsa autori/autorët nuk kanë të drejtë që ta shesin vetë librin dhe as ta imponojnë blerjen e tij nga studentët.

Neni 15

- 15.1. Numri i teksteve të botuar do të bazohet në mundësitetë financiare (planifikimin buxhetor).
- 15.2. Në rastet e tejkalimit buxhetor kërkesa për kompensim i përcillet Këshillit Drejtues të Universitetit për shqyrtim dhe miratim në mënyrë që fondet të shpërndahen në mënyrë proporcionale konform kapaciteteve financiare.
- 15.3. Mbështetja financiare sipas kësaj Rregulloreje realizohet nga kodi buxhetor përkatës në çdo vit fiskal dhe rekomandohet që ekzekutimi i pagesave të bëhet në vitin përkatës të botimeve.

Neni 16

- 16.1. Financimi i publikimeve bëhet nga mjetet e buxhetit të Universitetit dhe nga burimet e tjera (sponsorë, donatorë, mjetet e grumbulluara nga shitja e teksteve, etj.). Mjetet e grumbulluara nga sponsorët dhe nga shitja arkëtohen në konto të veçantë të Universitetit dhe shfrytëzohen për përkrahje të botimeve të reja.

Neni 17

- 17.1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen edhe për publikimet që bodojnë me mjetet të autorit, me përjashtim të Nenit 14 dhe 16 (paragrafëve përkatës) të kësaj Rregulloreje.

Neni 18

- 18.1. Çmimet dhe obligimet e tjera mes botuesit, autorit dhe subjekteve të tjera të parapara me këtë Rregullore përcaktohen me kontratë.



Neni 19

19.1. Rektorati i Universitetit (Shërbimi i financave) e bën kompensimin e shpenzimeve të publikimit për shtypjen e publikimit në përputhje me procedurat përkatëse. Përgjegjës për mjetet financiare lidhur me botimin është Prorektori për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë.

Neni 20

- 20.1. Shtëpia botuese e Universitetit i këmben, i jep pa kompensim ose i shet botimet e veta.
- 20.2. Shtëpia botuese e Universitetit botimet e veta i këmben me institucionet shkencore, universitet, fakultetet dhe organizatat e tjera shkencore-kulturore brenda dhe jashtë vendit.
- 20.3. Këmbimi bëhet sipas parimit, të gjitha botimet e Shtëpisë botuese me të gjitha botimet e institacioneve të tjera, libër me libër, pa pasur parasysh vlerën e tyre, ose libër me libër, sipas vlerës.
- 20.4. Këmbimet realizohen në bazë të marrëveshjeve paraprake të përfaqësuesve të institacioneve.

Neni 21

- 21.1. Universiteti ua ndan pa kompensim nga një kopje të çdo botimi:
 - Të gjithë profesorëve të njësisë nga vjen autori, nëse vjen nga Fakulteti përkatës; Rektoratit të Universitetit, Këshillit Drejtues, Dekanëve dhe Fakulteteve;
 - 10 kopje Bibliotekës së Universitetit "Ukshin Hoti";
 - 3 kopje Ministrisë së Arsimit, të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
 - 3 kopje Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sporteve;
 - 3 kopje Bibliotekës Universitare të Kosovës;
 - 3 kopje Bibliotekës Kombëtare të Kosovës sipas ligjit në fuqi;
 - 3 kopje Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë;
 - 2 kopje Bibliotekës së Institutit Albanologjik të Prishtinës;
 - 2 kopje Bibliotekës së Institutit të Historisë të Kosovës dhe
 - 2 kopje Bibliotekave përkatëse të fakulteteve të Universitetit "Ukshin Hoti".
- 21.2. Me kërkesën e institacioneve ose të individëve të interesuar, me lejim të Këshillit botues mund të jepen pa kompensim botimet e Shtëpisë botuese.
- 21.3. Këtyre botimeve u vihet vula "Dhuratë" e Shtëpisë Botuese të Universitetit "Ukshin Hoti".

Neni 22

- 22.1. Autorit dhe bashkautorit të botimeve u takojnë pa kompensim gjithsej 30 kopje.
- 22.2. Autorit dhe bashkautorit të punimeve të botimeve të përbashkëta (konferanca, tryeza dhe aktivitete të tjera shkencore) u takon nga një kopje pa kompensim.
- 22.3. Redaktorit, recensemtëve, lektorëve, shërbimeve të dizajnit dhe shërbimeve të tjera teknike u takon nga një kopje e botimit.

Neni 23

- 23.1. Botimet e Shtëpisë botuese shiten në Librarinë e Universitetit dhe në forma të tjera



legale.

- 23.2. Çmimet e shitjes i cakton Këshilli botues të aprovuara nga Këshilli drejtues.
- 23.3. Librarive u lejohet marzha e rëndomtë ose e kontraktuar.
- 23.4. Botimet e Shtëpisë botuese të Universitetit në raste të veçanta shiten edhe me ulje të çmimit deri në 50%.

Neni 24

- 24.1. Në arkivin e Universitetit ruhen nga pesë kopje të çdo botimi.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 25

- 25.1. Kjo Rregullore nuk mund të veprojë në mënyrë retroaktive në të drejtat e palëve që i afekton.
- 25.2. Për zbatimin e drejtë të kësaj Rregulloreje kujdeset kryetari i Këshillit Botues.
- 25.3. Interpretimin autentik të kësaj Rregulloreje e jep Senati i Universitetit.

Neni 26

- 26.1. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje bëhet sipas procedurës së miratimit.
- 26.2. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren dhe vlen për publikimet e miratuara pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.
- 26.3. Në përputhje me kompetencat Statutare, Këshilli drejtues jep pëlqimin financiar për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

